



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Gouvernement*

**Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera- The Prime Minister Office**

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publik, neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 40, Zyra e Kryeministrit shpallë:

---

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës :</b>	Zyrtar i/e Lartë për Kriteria Ekonomike,
<b>Klasa e pozitës :</b>	Profesional 1
<b>Koeficienti/ paga :</b>	G4-5.85
<b>Nr. i kërkuar :</b>	1
<b>Data e njoftimit :</b>	08/08/2023
<b>Afati për aplikim :</b>	24/08/2023 - 31/08/2023
<b>Institucioni :</b>	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
<b>Departamenti :</b>	Zyra për Kriteria Ekonomike dhe Treg të Brendshëm
<b>Divizioni :</b>	Divizioni për Ekonomi, Zhvillim Rajonal dhe Statistika
<b>Vendi Punës :</b>	Prishtinë
<b>Nr. i Referencës:</b>	RN00012192
<b>Kodi:</b>	RPC0005769



## **1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës**

---

1. Analiza e Strategjisë së Zgjerimit dhe Raportit të Vendit për Kosovën të Komisionit Evropian për sektorët në kuadër të fushave të përgjegjësisë;
2. Përgatitja e Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe dokumenteve tjera qeveritare në fushën e integritimit evropian në kuadër të fushave të përgjegjësisë;
3. Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKIE) dhe dokumenteve tjera qeveritare në fushën e integritimit evropian për sektorët në fushat e përgjegjësisë;
4. Përgatitja e materialeve dhe mbështetja e punës së Nën-komiteteve përkatëse të MSA-së me BE-në në fushën e kriterëve ekonomike dhe zbatimi i instrumenteve të BE-së në këtë proces;
5. Koordinimi dhe mbështetja e punës së strukturave negociuese qeveritare në fushën e kriterëve ekonomike të integritimit evropian;
6. Përgatitja e raporteve në bashkëpunim me institucionet përmes koordinimit të raportimit të rregullt në kuadër të procesit të integritimit evropian për fushën e kriterëve ekonomike;
7. Kontributi në hartimin e politikave sektoriale dhe mbështet harmonizimin e politikave me kërkesat e integritimit përmes opinionëve për dokumente të politikave (dokumente strategjike, koncept dokumente etj) në fushën e kriterëve ekonomike;
8. Bashkëpunimi dhe mbështetja për institucionet për avancimin të kapaciteteve institucionale, për përafrimin të legjislacionit me acquis dhe praktikat e mira të BE-së;
9. Kryen detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi.

## **2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta**

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende ;
- Të jetë vlerësuar të paktën mirë për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit,
- Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

## **3. Kërkesat e përgjithshme formale**

---

- *Arsimimi i kërkuar:* Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, në fushën Ekonomisë, tregut të brendshëm, tregtisë ndërkombëtare, dhe integritimit Evropian .
- *Kualifikime të posaçme formale:*
- *Përvoja e punës e kërkuar:* Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale.

## **4. Kërkesat ( Njohuri , Aftësi dhe cilësi ) e përgjithshme e nevojshme**

---

- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështje teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Cilësi gjatë kryerjes së detyrave në fushën profesionale;



- Aftësi organizative, planifikuese dhe analitike.
- Njohuri në programet e Microsoft Office;
- Njohje e rrjedhshme e gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar
- Njohuri të thella mbi politikat e BE-së, në veçanti politikat e kriterëve ekonomike, të zgjerimit të BE-së dhe politikat publike.
- Aftësi të mira komunikimi dhe pune grupore.
- Të jetë energjik dhe në gjendje të punojë me orar fleksibil dhe trysni kohe, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune.

## **5. Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e dorëzimit**

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve në fushën përkatëse
- Kopjet e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmonë se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (e vlefshme nga afati për aplikim).

## **6. Data e daljes së rezultateve dhe vlerësimi paraprak**

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë të shpallet me së largu deri më datën 07/09/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## **7. Data, vendi dhe ora ku zhvillohet intervista me gojë**

---

- 22/09/2023, Ndërtesa e Qeverisë, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë

## **8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë**

---

- Njohuri për fushëveprimin dhe natyrën e punës së Zyrës për Kritere Ekonomike dhe treg të brendshëm
- Njohuri për procesin e integritimit evropian përfshirë politikën e zgjerimit dhe kriteret ekonomike
- Njohuritë e gjuhës angleze
- Njohuri mbi politikat ekonomike në Kosovë përfshirë tregun financiar dhe industrinë e rrjetit. Aftësi analitike dhe metodologjike për fushën e ekonomisë
- Njohuri e legjislacionit për Zyrat Publike

## **9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

---

- Intervistë

## **10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

---

- Përmes e-mailit dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## **11. Mënyra e aplikimit**

---

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## **12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare**

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidateve , fituesi do të shpallet përmes portalit per rekrutim elektronik ( <https://konkursi.rks-gov.net> ) Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### **Të dhëna shtesë:**

Nuk ka

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

